

HAMIT KABA

**KUFIJTË E SHQIPËRISË NË PROJEKTET E ALEATËVE
TË MËDHENJ GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Kufijtë e Shqipërisë, në vija të përgjithshme, u caktuan nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Londrës të vitit 1913, ndërsa përcaktimi i tyre në terren u ndërpre nga Lufta e Parë Botërore. Problemi i kufijve të Shqipërisë u rihap në Konferencën e Paqes të Parisit të vitit 1919-1920, por nuk u arrit të zgjidhej. Konferenca e Ambasadorëve e Parisit (nëntor 1921) la në fuqi vendimin e vitit 1913 për kufijtë e Shqipërisë dhe ngriti një komision të ri për të përcaktuar ata në terren.¹ Më 1922, Vermoshi dhe Shën Naumi iu lanë Shqipërisë, por problemi mbeti i pazgjidhur, sepse nuk u pranua nga Jugosllavia. Më 1925, kryeministri i Shqipërisë, Ahmet Zogu u shfaq i gatshëm të pranonte kërkesat jugosllave. Kufijtë definitivë të Shqipërisë u fiksuan nga Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia më 30 korrik 1926. Traktati u firmos nga Shqipëria e Jugosllavia.²

Pas pushtimit të Jugosllavisë nga Gjermania në prill 1941, pjesa më e madhe e Kosovës, territoreve shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Malin e Zi, iu bashkuan shtetit shqiptar nën pushtimin italian me dekretin e Musolinit, të datës 12 gusht 1941³, ndërsa zona e Mitrovicës mbeti nën pushtimin gjerman dhe Kosova Juglindore nën atë bullgar. Pas kapitullimit të Italisë kontrolli i territoreve shqiptare i kaloi Gjermanisë, ndërsa Bullgaria zgjeroi zonën e saj të pushtimit duke përfshirë edhe disa territore që më parë i përkisnin shtetit shqiptar. Karta e Atlantikut (gusht 1941) nuk i njihte pushtimet e shteteve të Boshtit dhe ndryshimet me forcë të kufijve, rrjedhimisht, as kufijtë e shtetit shqiptar nën pushtim.

¹ *National Archives and Record Administration (NARA)*, Microcopy, 1211, Roll 4, 875.014/4, Myrton T. Herick (ambasadori amerikan në Paris) për Sekretarin e Shtetit, nr.669, 2 dhjetor 1921.

² *NARA*, 875.00/10-44, Probleme territoriale: Kufiri shqiptaro-jugosllav, Sekret N-46, 2 shtator 1943.

³ Sonila Boçi, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit 1939-1949*, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f.94; *The National Archives (TNA)*, WO 204/9558, *Shqipëria:1944*, përgatitur nga H. Hodkinson, BAF, korrik 1944

Sidoqoftë, parimisht, ajo nuk ua mbyllte dyert ndryshimeve të ardhshme, sepse pranonte parimin e vetëvendosjes së popujve. Nëse zbatohet Karta e Atlantikut, shqiptarët e zonave që iu bashkuan shtetit shqiptar do të kishin shanse t'i ktheheshin Shqipërisë.

Kufijtë e rinj të shtetit shqiptar, nuk u njohën as nga qeveria mbretërore jugosllave në emigracion dhe as nga ajo greke. Qeveritë e këtyre dy vendeve pranuan se nuk kishin kundërshtime për rivendosjen e pavarësisë së Shqipërisë, por “për arsye sigurie” ndaj ndonjë sulmi të mundshëm italian paraqitën “pretendime të veçanta” ndaj territoreve shqiptare. Ato pretenduan se duhet t'u merrej mendimi lidhur me statusin e ardhshëm të Shqipërisë.⁴ Në fund të shtatorit të vitit 1941, qeveria greke në emigracion do t'i kujtonte Foreign Office-it të drejtat e Greqisë për territoret e “Vorio Epirit”⁵. Qeveria jugosllave do të shfaqte pretendime ndaj Shqipërisë së Veriut nëse Greqia do të pretendonte Shqipërinë e Jugut. Kjo politikë u materializua më 1 nëntor 1941, kur Ninçic [ministër i qeverisë jugosllave në mërgim (Londër)] shfaqti pretendimin se Jugosllavia do të merrte Shkodrën dhe zonën përreth saj, për shkak të vlerave të veçanta ekonomike e strategjike që kishin krahinat shqiptare për Malin e Zi.⁶

Artikulli përbën një nismë për të trajtuar problemin e kufijve të shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore, në këndvështrimin e Aleatëve të Mëdhenj. Burimet dokumentare arkivore britanike e amerikane kanë qenë baza për hartimin e tij, pa përjashtuar ndonjë botim dokumentar të viteve të fundit nga arkivat ruse, disa dokumente për relacionet ndërleate të gjetur në arkivat e Perëndimit, si dhe disa studime të pjesshme të ndërmarra nga autorë shqiptarë gjatë viteve të fundit.⁷

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (LDB) u hartuan disa studime për Shqipërinë, kryesisht për statusin ndërkombëtar të saj pas Luftës së Dytë

⁴ NARA, 875.01/10-2144, “Statusi Ndërkombëtar i Shqipërisë”, përgatitur nga Komiteti Ndërdivizional për Rajonin Ballkaniko-Danubian në Departamentin e Shtetit, 6 maj 1944.

⁵ Arben Puto, *Nëpër analet e diplomacisë angleze*, Botim i dytë i ripunuar, Tiranë: 8 Nëntori, 1980, f. 53.

⁶ TNA, FO 536/5, G.W.Rendel për Athony Eden, 1 nëntor 1941.

⁷ Shih: Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar (1939-1949)*, Tiranë: GEER, 2002; Paskal Milo, “Statusi i Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore”, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2000, f. 165-176; Hamit Kaba, “Projekte të Aleatëve të Mëdhenj mbi të ardhmen e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore”, në *100 Vjet Pavarësi, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare*, Vëll.II, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2014, f. 173-189; S. Boçi, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit ...*

Botërore dhe për kufijtë veriorë e jugorë të saj. Me përjashtim të deklaratave të ministrave të jashtëm të Britanisë së Madhe, SHBA dhe Bashkimit Sovjetik (dhjetor 1942), studimet për Shqipërinë u përgatitën kryesisht nga institucionet e specializuara për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kufijtë, në shërbim të Foreign Office-t, apo të Department of State (Departamentit të Shtetit -DSH). Shumica e studimeve britanike që njohim u hartuan nga Instituti Mbretëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Oxfordit në Londër, ndërsa ato amerikane nga Sektori i Çështjeve të Evropës Jugore dhe Sektori i Studimeve Territoriale. Fragmente të studimeve sovjetike për Shqipërinë kemi hasur në ndonjë botim dokumentar rus të viteve të fundit, si dhe në dokumente të veçanta të arkivave britanike e amerikane, por studime të plota për kufijtë apo për çështjen shqiptare në përgjithësi, gjatë LDB nuk kemi gjetur⁸.

Studimet e ndërmarra synonin t'u paraprinin vendimeve të pritshme të Fuqive të Mëdha Aleate për riorganizimin e Ballkanit, e më gjerë të Evropës e të Botës në periudhën e pasluftës. Ato duhen konsideruar kryesisht si refleksione të memorandumëve të ministrave të tyre të jashtëm për çështjen shqiptare, më shumë se sa konkluzione, apo politika përfundimtare të tyre. Studimet e kryera prej institucioneve të specializuara nuk kanë qenë gjithnjë në të njëjtën rezonancë me politikat zyrtare të qeverive të tyre. Përgjithësisht në to pasqyroheshin në kompleksitet të gjitha variantet që mund t'i shërbenin në të ardhmen, duke marrë në konsideratë edhe rrethanat hipotetike dhe ndryshimet që mund të ndodhnin nga koha në kohë. Studimet e kryera përmbushën në përgjithësi qëllimet për të cilat ato u hartuan, "të ushqenin" institucionet e larta vendimmarrëse me lëndën e nevojshme për të ndërtuar politikat mbi Shqipërinë, ndërsa vendimmarrja në fakt ishte një produkt kolektiv i qeverive dhe i organizmave ndërkombëtarë.

Qeveria britanike, ndryshe nga ajo amerikane e njohu zyrtarisht pushtimin dhe aneksimin e Shqipërisë nga Italia fashiste⁹. Refuzimi i amerikanëve ndaj pushtimit të Shqipërisë u bë i njohur nga deklaratat e

⁸ O. A., Ржевский, *Сталин и Черчилль. Встречи. Беседы. Дискуссии. Документы, комментарии, 1941-1945*, Москва: Наука, 2004, с. 37-38; TNA, FO 536/5, p. 30.

⁹ Bisser Petrov, "Great Britain and Resistance in Albania, 1943-1944". *Academie Des Sciences de Bulgarie, Institute D'Etudes Balkaniques*, No. 2, Sofia: 2006, p.88.

butë, e paraqitur nga sekretari Amerikan i Shtetit më 8 prill 1939.¹⁰ Dokumentacioni britanik i viteve 1941-1942 priret nga ideja e rinjohjes së kufijve të shtetit jugosllav të periudhës së parapushtimit dhe copëtimit të Jugosllavisë, pa lënë mënjanë edhe alternativën e cedimit të mëtejshëm të kufijve të shtetit shqiptar në favor të Jugosllavisë. Studimet, për arsye të njohura, shtohen veçanërisht në vitet 1943-1944. Shtimi numerik shoqërohet edhe me rritjen e dozave të realizmit, duke parashikuar në ndonjë rast të veçantë edhe ndryshime kufijsh në favor të Shqipërisë. Sidoqoftë nuk kemi hasur në ndonjë studim, i cili do të parashikonte ndonjë opsion që do të çonte në bashkimin e plotë të territoreve shqiptare. Në studimet britanike mbizotëron ideja, se shteti shqiptar do ta kishte të vështirë të qëndronte në këmbë i vetëm, pa ndihmën e të tjerëve, për shkak të orekseve nacionaliste të fqinjëve grek e jugosllavë, vështirësive ekonomike e financiare, aftësive jo të arrira qeverisëse të shqiptarëve, dasive të tyre fetare, tendencave centrifugale etj.¹¹ Duke pasur në konsideratë të tilla vlerësime janë paraparë forma të ndryshme të ekzistencës së shtetit shqiptar, brenda të cilave do të gjente zgjidhje edhe problemi shqiptar: përkatësisht në formën e një Federate apo Konfederate; Bashkimi apo Pakti Ballkanik; Federatë të Vendeve të Evropës Lindore. Janë projektuar gjithashtu skema të tilla, si vënia e shtetit shqiptar nën një mandat britanik apo amerikan, protektorat, madje edhe qenien e tij nën mbikëqyrjen e një organizmi kolektiv, të ngjashëm me Lidhjen e Kombeve, e cila mund të krijohet pas mbarimit të LDB, për një Shqipëri neutrale nën kontrollin ndërkombëtar dhe me sovranitet të kufizuar etj.¹²

Studime për statusin ndërkombëtar të Shqipërisë, kufijtë dhe qeverisjen e saj në fazën e tranzicionit dhe më tej, janë përgatitur edhe nga sektorë të profilizuar të Departamentit të Shtetit.¹³ Duhet të pranojmë, se pavarësisht nga vlerat e tyre dhe dëshira e mirë për të ndërtuar një shtet normal shqiptar, në këto studime vihet re një lloj

¹⁰*Peace and War: United States Foreign Policy, 1931-1941*, (Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office, 1943), p.455; NARA, Roll 15, 875.01/426, Përgjigje e Paul T. Culbertson (ndihmësshëf i Divizionit të çështjeve Europiane) për Spiro Ford, 11 nëntor 1942.

¹¹TNA, FO 3717/29711, H. Beeley për Mr. Nichols, 18 shkurt 1941, f. 77-88.

¹²NARA, 875.00/10-2144, Studim "Statusi Ndërkombëtar i Shqipërisë" i hartuar nga Komiteti për Rajonin Ballkaniko-Danubian pranë Departamentit të Shtetit, më 6 maj 1944.

¹³NARA, Microfilm Publications, Roll 15, 875.00/10-44, 16 tetor 1944.

mosnjohje e mirë e realitetit shqiptar, veçanërisht për zhvillimet e brendshme të Shqipërisë. Ndonëse vetë hartuesit e tyre pranojnë se “qëllimi është ndihma ndaj Shqipërisë dhe jo kontrolli i huaj mbi të”, disa skema e propozime të tyre për statusin ndërkombëtar dhe qeverisjen e Shqipërisë gjatë një periudhe tranzitive të pacaktuar duken larg realitetit. Sidoqoftë, duke bërë një vështrim krahasues ndërmjet studimeve britanike e amerikane, do të gjykoja se alternativat e paraqitura nga SHBA për problemet e kufijve të Shqipërisë, ishin më realiste e të pranueshme se ato britanike, por asnjëherë të mjaftueshme për të përmbushur aspiratat e shqiptarëve.

Qëndrimi i BRSS ndaj problemit shqiptar dhe kufijve, për mungesë dokumentacioni dëshmohej në mënyrë episodike. Në bisedën e zhvilluar në Moskë, më 16 dhjetor 1941, ndërmjet delegacionit sovjetik të kryesuar nga Stalini dhe delegacionit britanik, të kryesuar nga sekretari i Jashtëm Anthony Eden, Stalini, krahas të tjerave paraqiti edhe “skemën e përgjithshme të riorganizimit të kufijve evropianë të pasluftës”, duke përmendur edhe Jugosllavinë, Greqinë dhe Shqipërinë. Stalini i kërkoi sekretarit britanik, që krahas të tjerave të pranonte “rimëkëmbjen e Jugosllavisë në kufijtë e vjetër, me disa zgjerime në kurriz të Italisë në Trieste, Fiume dhe në ishujt e Adriatikut” dhe “rindërtimin e Greqisë në kufijtë e saj të vjetër”.¹⁴ Për Shqipërinë, ndryshe nga vendet e tjera Stalini, shprehu mendimin se ajo “mund të rimëkëmbej si shtet i pavarur, nën garancinë e fuqive të tjera”.¹⁵ Por më pas, delegacioni sovjetik e modifikoi qëndrimin e vet dhe pranoi konceptin e Shqipërisë së pavarur, por duke e vendosur pavarësinë e saj nën garancinë e të Mëdhenjve. Ekzistenca e një shteti shqiptar të pavarur në periudhën e pasluftës u pranua gjithashtu si koncept, në takimin e Eden-it me ambasadorin sovjetik në Londër, Maisky, më 13 janar 1942.¹⁶ Maisky mbështeti plotësisht idenë e Eden-it për ekzistencën e një Shqipërie të pavarur pas lufte, si dhe vështirësitë që do të haste ajo nga pretendimet greke e jugosllave për kufijtë.¹⁷ Koncepti i ekzistencës së një Shqipërie të pavarur u fiksua zyrtarisht në deklaratën e Komisarariatit të Punëve të Jashtme të BS për Shqipërinë në dhjetor 1942, në të cilën thuhej se “BS

¹⁴ O. A. Ржешевский, *Сталин и Черчилль. ...*, с. 38.

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ TNA, FO 371/33107, f. 12, Informacion i Anthony Eden për S. Crpps (Kuibyshev), 13 janar 1942.

¹⁷ *Po aty.*

nuk njihje pretendimet e imperializmit italian ndaj territorit shqiptar, por pranonte rivendosjen e pavarësisë së saj”.¹⁸

Nëse do të bëja një krahasim mbi pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe kufijtë e saj gjatë Luftës së Parë Botërore (LPB), Konferencës së Paqes të Parisit të vitit 1919, Konferencën së Ambasadorëve në Paris (nëntor 1921), me pozitën e saj gjatë dhe në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, do të nënvizoja veçoritë e mëposhtme: *së pari*, gjatë dhe pas LDB nuk ndodhi sikurse në LPB, kur problemi i pavarësisë së Shqipërisë mbeti pezull e u rihap në Konferencën e Paqes së Parisit. Përkundrazi, tre Aleatët e Mëdhenj anglo-sovjeto-amerikanë, në dhjetor 1942, riafirmuan të drejtën e ringritjes së shtetit të pavarur shqiptar pas mbarimit të luftës, dhe i njohën popullit shqiptar të drejtën për të vendosur për formën e qeverisjes dhe për të zgjedhur qeverinë që ata dëshironin mbi bazën e Kartës së Atlantikut. Këto vendime mbetën pikë reference dhe të pandryshueshme në periudhën e mëpasshme, me gjithë dilemat e krijuara në mbarim të luftës, si rezultat i fitores së Frontit Nacionalçlirimtar në Shqipëri dhe epërsisë sovjetike në Ballkan. Ajo ç’ka mbeti e diskutueshme, sipas mendimit tim, të mbështetur në dokumentacionin më të fundit britanik e amerikan, ishte natyra e pavarësisë së shtetit shqiptar, nëse ai do të ishte plotësisht i pavarur, apo do të kalonte një periudhë prove të një sovraniteti apo vetëvendosjeje të kufizuar. Koncepti për sovranitetin e kufizuar përfshinte: një vetëvendosje të kufizuar, duke paraparë drejtimin e vendit nga një trupë e përkohshme këshilltarësh të huaj, mbikëqyrjen e tij nga një autoritet ndërkombëtar, ekzistencën e Shqipërisë nën një mandat britanik, amerikan apo edhe italian etj., të cilët do të kishin kompetenca të caktuara në një periudhë tranzitore, deri në kohën e kalimit në pavarësi të plotë.

Së dyti, problem delikat dhe i diskutueshëm ishte ai i kufijve të Shqipërisë. Sekretari Eden do të deklaronte në Dhomën e Komuneve më 17 dhjetor 1942: “Qeveria e Madhërisë së Tij e shikon çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas lufte, si një çështje që do të duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes”.¹⁹ Me këtë deklaratë qeveria britanike shpallte mosangazhimin e saj për ruajtjen e kufijve të shtetit shqiptar të paraluftës dhe ekspozimin e tyre ndaj pretendimeve greke.²⁰ Ndërhyrjen e

¹⁸TNA, FO 371/33109, Deklarata e BRSS për Shqipërinë, 18 dhjetor 1942, f. 89.

¹⁹TNA, FO 371/33107, viti 1942, f. 57.

²⁰B. Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar ...*, f. 94-95.

qeverisë greke në emigracion për këtë problem e pranon qartazi P. Dixon më 18 dhjetor 1942, në takimin e tij me sekretarin e ambasadës amerikane në Londër, zotin Coe. “Në lidhje me problemin e kufijve, deklaronte Dixon, ne morëm në konsideratë pretendimet e forta greke në lidhje me kufijtë jugorë të Shqipërisë”.²¹

SHBA, në deklaratën e tyre të 10 dhjetorit 1942, të paraqitur nga sekretari i Shtetit Hull, nuk e përmendën fare problemin e kufijve të ardhshëm të Shqipërisë, gjë që nuk u prit mirë as nga qeveria greke në emigracion, dhe as nga qeveria britanike e cila do të kishte dashur që qeveritë e dy vendeve të flisnin me një zë të vetëm. Qeveria greke dhe ajo britanike i kërkuan qeverisë amerikane që ta modifikonte deklaratën e saj për Shqipërinë dhe ta përshtaste atë me deklaratën britanike, duke e lënë të hapur çështjen e kufijve. Një kërkesë e tillë iu bë e njohur zëvendës-sekretarit Amerikan të Shtetit, Welles, nga ambasadori grek në Washington, Cimon Diamantopulos, më 21 dhjetor 1942.²² Por, Welles do të përgjigjej se “deklarata amerikane kishte qenë standarde, si edhe për vendet e tjera të okupuara, duke shtuar më tej se, kjo qeveri nuk ka bërë dhe nuk merr ndonjë angazhim sekret në lidhje me ndryshimet territoriale të ndonjë vendi tjetër, dhe se askush në Kombet e Bashkuara nuk do të marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me këto rregullime deri në përfundim të luftës”.²³ Qëndrim më të kujdesshëm se qeveria greke në emigracion ndaj deklaratës së Hull për Shqipërinë mbajti Lidhja Kombëtare Panepirote e grekëve të Amerikës, e cila nuk e atakoi direkt atë, por solli në vëmendjen e Departamentit disa dokumente që ndryshonin prej saj, të tillë si deklaratën e qeverisë britanike, por edhe disa komente të shtypit grek dhe të qeverisë kuislinge shqiptare.²⁴ Qeveria amerikane nuk pranoi as “sugjerimin e veçantë” të ambasadorit grek, që të pranonte në heshtje dhe me rezervë ndryshimet që mund të bëheshin në të ardhmen për kufijtë. Më 23 dhjetor 1942, qeveria amerikane do të hidhte poshtë zyrtarisht kërkesën greke të lartpërmendur.²⁵ Ky qëndrim iu bë i ditur edhe ambasadorit britanik në

²¹ *Po aty*, f.106, Nga takimi i P. J. Dixon me Coe, 18 dhjetor 1942.

²² NARA, Roll 15, 875.01/459, Memorandum bisede ndërmjet ambasadorit grek në Washington, Cimon Diamantopulos me zv.sekretarin Amerikan të Shtetit Welles, më 21 dhjetor 1942.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, 875.01/469, Letër e Lidhjes Kombëtare Panepirote Greke drejtuar Paul H. Alling, shef i Divizionit të Çështjeve të Lindjes së Afërme, më 30 dhjetor 1942.

²⁵ NARA, Roll 15, 875.01/459.

Washington, Halifax, qeveria e të cilit kishte kërkuar nga qeveria amerikane që “të shprehte diçka më shumë në lidhje me Shqipërinë”. Kërkesa britanike u cilësua si e pakuptimtë”.²⁶ Qeveria greke në emigracion ishte tejet e ndjeshme ndaj shprehjeve dhe frazave të dala nga institucionet apo zyrtarë të lartë të SHBA që përmendnin direkt apo indirekt kufijtë e Shqipërisë. Ambasadori grek në Washington do t’i kërkonte sqarime DSH për frazën e hedhur nga ky i fundit, e cila fliste për ‘integritetin dhe pavarësinë e Shqipërisë’. DSH dha sqarimin se kjo frazë nuk kishte si qëllim të paragjykonte çështjen e kufijve të Shqipërisë, të cilat duhet të përcaktoheshin pas luftës.²⁷

Tek disa drejtues të Zyrës së Shërbimeve Strategjike për Shqipërinë (Office of Strategic Services-OSS) në Washington, ende pa u publikuar deklarata britanike për Shqipërinë, kishin zënë vend dyshime në lidhje me ekzistencën e një marrëveshjeje verbale sekrete, ndërmjet qeverisë britanike dhe qeverive mbretërore greke e jugosllave në emigracion për ndarjen e Shqipërisë.²⁸ OSS, që po planifikonte të futej në Shqipëri ishte e interesuar të gjente një ambient miqësor dhe rezistencë aktive të shqiptarëve kundër pushtuesit, si garanci për suksesin e misionit të tyre në Shqipëri. Por, tek disa prej tyre ekzistonin opinione se Amerika nuk po e ndihmonte Shqipërinë sa duhej, ndërsa Anglia preferonte ndarjen e saj. Nëse një bindje e tillë do të ekzistonte edhe tek guerilët shqiptarë, arsye tohej në letër të OSS, atëherë anëtarët e misionit amerikan do të shiheshin më shumë si armiq, sesa si miq në këtë vend. Në këto rrethana, OSS përgatiti një deklaratë-draft për njohjen e Shqipërisë së pavarur, dhe ia rekomandoi DSH për miratim. Në komentin që iu bë këtij dokumenti në DSH u nënvizua se “Brannon dhe Frank Soyre [zyrtarë të OSS, H.K.] ishin të bindur se ekzistonte së paku një mundësi, që Britania e Madhe ka pasur bisedime jozyrtare me Greqinë e Jugosllavinë, që parashikonin ndarjen e Shqipërisë ndërmjet të dyjave”.²⁹ Këshilltari për Politikën e Jashtme në Departamentin e Shtetit, Wallace Murrey iu drejtua ambasadorit amerikan në Londër, Anthony Drexel Biddle, që të kërkonte sqarime nga qeveria britanike në lidhje me dyshimet e OSS, ndërsa nga ana e vet ai shfaqti opinionin se “nuk kam vënë re ndonjë të dhënë, se

²⁶ *Po aty*, 875.01/460.

²⁷ *Po aty*, Roll 15, 875.01/551, Sqarim i Paul H. Alling në Sektorin e Çështjeve të Lindjes së Afërme në DSH, më 30 nëntor 1943.

²⁸ *Po aty*, 875.01/492, Letër e Brannon për Atherton dhe Murrey, më 30 nëntor 1942.

²⁹ *Po aty*.

qeveria britanike parashikon ndarjen e Shqipërisë. Nëse ajo ekziston dhe nëse janë zhvilluar bisedime me grekët dhe jugosllavët mbi këtë çështje, unë mendoj se duhet të njihemi me to menjëherë”.³⁰ Më 19 dhjetor, ambasadori amerikan në Londër u dha përgjigje dyshimeve të mësipërme, duke nënvizuar se qeveria britanike, një vit më parë u kishte dhënë përgjigje të qartë pretendimeve greke e jugosllave, duke refuzuar të diskutonte me qeveritë e tyre aspekte të çështjeve territoriale gjatë zhvillimit të luftës.³¹ Sidoqoftë nënkuptimet e rretheve zyrtare greke e jugosllave për ndarjen e Shqipërisë së pasluftës nuk kishin kaluar pa u vënë re në Departamentin e Shtetit. Pikëpamjet e fqinjëve të Shqipërisë justifikoheshin me teza të tilla se “Shqipëria e pavarur do të ishte një shtet i dobët, jo i qëndrueshëm dhe i paaftë për të parandaluar ndonjë fuqi armike ndaj Greqisë e Jugosllavisë”.³² Departamenti i Shtetit nuk i mori në konsideratë këto “zgjidhje”, por i konsideroi ato të papranueshme, për shkak të mospërputhjes së tyre me Kartën e Atlantikut, me deklaratat e qeverive amerikane, britanike e sovjetike [dhjetor 1942], por edhe për telashet që do të shkaktonte shtimi i minoritetit shqiptar brenda këtyre shteteve.

Deklarata britanike mori vlerësime pozitive nga komuniteti shqiptar i Amerikës dhe nga Zogu, përsa i përket pranimin të një Shqipërie të pavarur, por u përball me kundërshtime për problemin e kufijve. Deklarata britanike për Shqipërinë ndeshi gjithashtu në kundërshtimin e qeverisë kuislinge shqiptare të kryeministrit Mustafa Kruja, i cili e quajti atë “si kërcënim për integritetin territorial të Shqipërisë, se grekët dhe jugosllavët do t’i zhvatnin Shqipërisë territoriale me mbështetjen e Aleatëve”.³³

Ndërsa deklarata e Hull, përveç vlerësimeve që mori nga komuniteti shqiptar në SHBA, nga “Vatra” e “Shqipëria e Lirë”, Kisha Ortodokse Autoqefale e drejtuar nga F. S. Noli, nga Mbreti Zog I dhe shoqata “Miqtë e Shqipërisë”, u shoqërua edhe me kërkesa për ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Shqiptarët e Amerikës kërkuan garanci se pas lufte nuk do të ndryshonin kufijtë e Shqipërisë. Noli, në

³⁰TNA, Roll 15, 875.01/467, Letër e Wallace Murrey për Atherton dhe zotin Biddle, më 4 dhjetor 1942.

³¹Po aty, 875.01/473, Informacion i Anthony Drexel Biddle për Departamentin e Shtetit, më 19 dhjetor 1942.

³²NARA, 875.00/10-2144, 6 maj 1944.

³³Po aty, Roll 15, 875.01/539, Warrison nga Berna për sekretarin e Shtetit, 31 dhjetor 1942.

emër të Kishës Ortodokse Autoqefale, i bënte të ditur sekretarit të Shtetit, Hull, se Greqia e Jugosllavia kishin shpallur zyrtarisht ndarjen e Shqipërisë.³⁴ “Vatra” shkruante se Shqipëria do të përballet me një copëtim të dytë, më të keq se ai i vitit 1912 [1913], duke kërkuar garanci definitive në lidhje me fatin e ardhshëm të vendit të tyre në Konferencën e Paqes.³⁵ Vasil Pani (president në detyrë i “Vatrës”, H.K.) i kërkoi sekretarit Amerikan të Shtetit që çështja shqiptare, duke përfshirë edhe kufijtë të diskutohej e zgjidhej në Konferencën e Washington-it, që do të mbahej së afërmi.³⁶ Konstandin Çekrezi do të ankohej në Departamentin e Shtetit se deklarata e Eden në lidhje me kufijtë e Shqipërisë e kishte shfuqizuar deklaratën e shkëlqyer të Hull dhe kishte paralizuar lëvizjen e rezistencës.³⁷ Çekrezi, në emër të organizatës “Shqipëria e Lirë”, i akuzonte britanikët se nuk donin të vendosnin kontakte me gueriljet shqiptare për shkak të premtimit sekret që u kishin bërë Jugosllavisë e Greqisë, për ta ndarë Shqipërinë.³⁸

Mospërmendja e problemit të kufijve në deklaratën amerikane nuk do të thoshte se kjo çështje nuk do t’i nënshtrohej diskutimeve pas luftës, por as që fati i saj do të vendosej në favor të Greqisë. SHBA si dhe Britania e Madhe u përpoqën të mos lejonin kalimin e forcave greke në territorin shqiptar në mbarim të luftës, por premuan se do t’i dëgjonin pretendimet greke në Konferencën e ardhshme të Paqes.³⁹ SHBA “nën zë” dhe jo zyrtarisht, gjatë kohës së luftës, por edhe pas mbarimit të saj, ishin shprehur në disa raste, për mosndryshimin e kufijve të Shqipërisë. Amerikanët, si edhe për shumë çështje të tjera madhore, ashtu edhe për problemin e kufijve iu shmangën diskutimeve gjatë periudhës së LDB, duke adoptuar formulën e mençur të shqyrtimit të tyre në një konferencë të ardhshme të pasluftës. Mbi këtë logjikë, në rrethana disi të ndryshuara në marrëdhëniet e Aleatëve të Mëdhenj Perëndimorë me Bashkimin

³⁴ *Po aty*, Roll 15, 875.01/449, Telegram i F.S. Nolit drejtuar C. Hull, 18 dhjetor 1942; *Po aty*, 875.01/461; *Po aty*, 875.01/463.

³⁵ *TNA*, FO 371/37138, f. 11, Telegram i Vasil Panit drejtuar Anthony Eden, më 19 janar 1943.

³⁶ *NARA*, M15, 875.01/500, Telegram i Vasil Panit drejtuar Hull, më 15 mars 1943.

³⁷ *Po aty*, M15, 875/01, Telegram i Konstandin Çekrezi për Francis B. Sayre-ndihmës special i sekretarit të DSH, më 15 mars 1943.

³⁸ *Po aty*, M11211, R15, 875.01/409, Telegram i Konstandin Çekrezi drejtuar Cordell Hull, më 29 mars 1943.

³⁹ *Po aty*, 875.01/11644, Telegram i Edward Stettinious [nënsekretar i Shtetit] drejtuar Caserta-s, më 6 tetor 1944.

Sovjetik; me rreshtimin e Shqipërisë me këtë të fundit dhe me synimin për t'u dhënë satisfaksion votuesve grekë, që të votonin për formën monarkike të qeverisjes, delegacioni amerikan i kryesuar nga sekretari i Shtetit, Byrnes dhe 11 delegacione të tjera, më 3 gusht 1946 votuan për diskutimin e pretendimeve tokësore greke ndaj Shqipërisë në Këshillin e Ministrave të Jashtëm.⁴⁰ Por, vetëm disa ditë pas fitores së monarkisë në plebishitin e organizuar në Greqi më 1 shtator 1946, delegacioni grek me sugjerimin e amerikanëve e tërhoqi kërkesën nga rendi i ditës i Konferencës së Paqes, për t'ia kaluar atë Këshillit të Ministrave të Jashtëm.⁴¹ Ky i fundit nuk u mor fare me të, por qeveria greke dhe rrethe të caktuara brenda dhe jashtë vendit nuk kanë hezitur ta përdorin atë si një "kartë" për të justifikuar pretendimet tokësore ndaj Shqipërisë në vitet e ardhshme.

Politika parimore dhe njëkohësisht pragmatiste e SHBA nuk e pengoi Departamentin e Shtetit, që përmes organizmave të specializuara, të përgatiste disa studime të rëndësishme për Shqipërinë, duke përfshirë edhe studimet për kufijtë jugorë e veriorë të saj.

Kufijtë veriorë të Shqipërisë: Studime britanike

Studimi i parë që kam pasur mundësi të njoh, titullohet: *"Realizueshmëria e shtetit të ardhshëm shqiptar"*⁴². Ai u hartua më 18 shkurt 1941 nga Andrew Rayan, me porosi të Institutit Mbretëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, (Departamenti: Kërkimi i Jashtëm dhe Shërbimi i Shtypit), pranë Balliol College, Oxford. Autori në përgjithësi mendon se, shteti shqiptar i pasluftës duhet të ketë të njëjtët kufij si të paraluftës. Por, Rayan shton, Britania e Madhe nuk duhet ta privojë Jugosllavinë nga ndonjë pjesë e rëndësishme e territorit të saj, për t'ia dhënë atë Shqipërisë. Përkundrazi, arsyeton ai, Jugosllavia mund të aspirojë pjesë të veriut të Shqipërisë. Duke dashur të justifikojë këtë version ai sjell një referencë të gazetës *'The Times'*, sipas të cilës edhe

⁴⁰Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti 1948, dosja 19, "Marrëdhëniet e R.P. të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik prej çlirimit e deri më sot", f. 31-33.

⁴¹Po aty.

⁴²TNA, FO 371/29711, Andrew Rayan "Realizueshmëria e shtetit të ardhshëm shqiptar", shkurt 1941, f. 77-88; Andrew Rayan: Konsulli i Përgjithshëm i Britanisë së Madhe në Shqipëri në vitet 1936-1939.

Hitleri u kishte ofruar ministrave jugosllavë, që e vizituan atë më 14 shkurt 1941 [në shkëmbim të një aleance me Jugosllavinë], territore shqiptare, që përfshinin qytetin e Shkodrës dhe pjesën e luginës së lumit Drin. Për autorin ndonjë cedim i kufijve të Shqipërisë në veri nga pikëpamja ekonomike, do ishte më pak i ndjeshëm për të, se sa ndonjë kalim territori në jug, në favor të Greqisë. Rayan, ashtu si edhe shumica e studiuesve të tjerë britanikë e shihte të vështirë mbijetesën e një shteti shqiptar të pavarur dhe me kufij të cinguar pas luftës. Prandaj mbështeste idenë e përfshirjes së saj një Pakt Ballkanik, ku do të aderonin edhe vendet e tjera të këtij rajoni. Duke e njohur mirë realitetin shqiptar dhe dëshirën e tyre për pavarësi të plotë, ai arrinte në përfundimin se ata [shqiptarët] duhet të liheshin të lirë të zgjidhnin vetë. “Shqipëria, përmendte ai, nuk zotërohet me forcë, por ajo duhet lënë e lirë që të pranojë ose refuzojë kontrollin [e huaj], për të përfituar apo lënë mënjanë ndihmën e tyre”⁴³.

Studimi i dytë “*Kufijtë shqiptaro-jugosllavë*” u hartua në janar 1942 nga R.G.D. Laffan⁴⁴ i të njëjtit institut të përmendur më lart. Pjesën kryesore të tij e zë problemi i kufijve shqiptaro-jugosllavë. Autori sjell dy versione për të ardhmen e Shqipërisë dhe problemin e kufijve të saj: 1. Shqipëria-shtet tërësisht i pavarur; 2. Shqipëria-shtet i pavarur, por i përfshirë në një Federatë Ballkanike apo në një Federatë të gjerë të vendeve të Evropës Lindore. Autori analizon dy situata hipotetike në lidhje me kufijtë e Shqipërisë: në situatën e parë presupozohej që Jugosllavia të merrte një minimum territoresh shqiptare; ndërsa në versionin tjetër, asaj duhej që t’i përmbusheshin të gjitha pretendimet tokësore ndaj Shqipërisë. Të dyja versionet analizohen nga pikëpamja etnologjike, strategjike dhe ekonomike. Autori mendonte se nga pikëpamja etnologjike nuk mund të justifikoheshin pretendimet jugosllave, sepse brenda kufijve të shtetit shqiptar nuk kishte pakica sllave. Përkundrazi, nëse merrej për bazë ky kriter, duhej të ishte Jugosllavia ajo që do t’i kthente Shqipërisë territoret ku banonin shqiptarët. Autori mendonte se Jugosllavia kishte avantazhe strategjike me kufirin e parapushtimit të saj, ndërkohë që ndryshimet e mëtejshme do të ishin komplet në favor të saj, dhe krejt në disfavor të Shqipërisë. Duke e parë të pamundur daljen e Serbisë në portin e Selanikut, ai

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *Po aty*, FO 371/33107, “Kufijtë shqiptaro-jugosllavë”, përgatitur nga R.D.G. Laffan, më 6 janar 1942.

mendon se Jugosllavisë i duhej një rrugë komunikimi përmes Shkodrës dhe zonës rreth saj, që do të përfshinte edhe Lezhën. Edhe nga pikëpamja ekonomike Laffan gjykonte, se Serbisë duhej t'i sigurohej një dalje në Adriatik, duke ndërtuar rrugë hekurudhore që do të kalonte në Shkodër, duke përfshirë ultësirën e Drinit dhe portin e Mjedës (Medua). Sipas tij, Jugosllavia do të bënte të mundur atë që nuk e kishin bërë shqiptarët, përmirësimin dhe drenazhimin e tokave rreth liqenit të Shkodrës. Në variantin tjetër parashihej që Jugosllavisë t'i jepej jo vetëm zona e Shkodrës dhe e Mjedës, por e gjithë Shqipëria Veriore. Pyetjes se, a do të ishte në gjendje shteti i pavarur shqiptar të mbijetonte, duke i gjymtuar më tej trupin e tij, ai do t'i përgjigjej në mënyrë cinike, se edhe nëse Shqipëria humbet veriun e saj, ajo mund të mbijetojë, sepse në fund të fundit, "në çdo rast ajo duket e paaftë të ekzistojë". Autori e përfundon studimin me parashikimin ogurzi se "fati i ardhshëm i Shqipërisë përfundimisht është ndarja e saj nga fqinjët, ose përfshirja në një Federatë të gjerë të vendeve të Evropës Lindore, por të padominuar nga fqinjët".

Majori Barbrook, një ish oficer britanik në xhandarmërinë shqiptare gjatë kohës së Zogut, u ngarkua që t'u bënte oponencën dy studimeve më të fundit për kufijtë shqiptaro-jugosllavë dhe për çështjen shqiptare në përgjithësi. Në thelb ai paraqiti disa kundërshtime për këtë çështje. Barbruk nuk shihte ndonjë arsye që Shkodra t'i bashkohej Jugosllavisë, për të garantuar daljen e Serbisë në det. Sidoqoftë, Barbruk besonte se Jugosllavia nuk do të pajtohej me kufijtë ekzistues dhe prandaj e quante të arsyeshme krijimin e një federate ballkanike, brenda së cilës do të përfshihej edhe Shqipëria. Në këtë mënyrë, kufijtë e brendshëm të vendeve ballkanike do ta humbnin rëndësinë⁴⁵.

Studimi i tretë i titulluar: "*Shqipëria si një problem ndërkombëtar*" u përgatit më 23 shkurt 1943⁴⁶, nga dy studiues me emër të Institutit Mbretëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare-Macartney dhe Laffan. Studimi analizon më në thellësi problemin e së ardhmes së Shqipërisë, ku një vend të konsiderueshëm zë edhe problemi i kufijve të ardhshëm të saj. Rikthimi i Shqipërisë në kufijtë e vitit 1926, do të linte nën Jugosllavi një numër të madh shqiptarësh, të përfshirë në kohën e këtij studimi në 'Shqipërinë e Madhe' të krijuar nga fuqitë e Boshtit. Sipas dy autorëve të përmendur, tek shqiptarët e krahinave që iu bashkuan

⁴⁵Po aty, FO 371/37135, "Shënime për Shqipërinë", Nënkomiteti Ushtarak, Sekretariati i Rindërtimit drejtuar FO, më 30 dhjetor 1942.

⁴⁶Po aty, FO 371/37135, "Shqipëria si problem ndërkombëtar", shkurt 1943.

Shqipërisë në vitin 1941 ishte rritur ndërgjegjja kombëtare. Ai veçonte sidomos shqiptarët e krahinave të Dibrës, Strugës, Kosovës dhe Rrafshit të Metohisë. Jugosllavia në mbarim të luftës do të rikërkonte territoret e bashkuara me Shqipërinë nga fuqitë e Boshtit, por mund të pretendonte më tej për Shkodrën dhe luginën e lumit Drin. Situata që do të krijohet do të ishte e vështirë, dhe detyrimi ndërkombëtar për të vendosur kufij të arsyeshëm ndërmjet dy vendeve mund të mos pranohej as nga Shqipëria dhe as nga Jugosllavia, gjë që do të sillte mungesë stabiliteti në Ballkan.

Siç del nga dokumentacioni britanik, qeveritë mbretërore jugosllave e greke në marrëveshjen e nënshkruar prej tyre më 15 janar 1942 kishin pranuar ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar të pasluftës dhe përfshirjen e tij në Bashkimin Ballkanik. Qeveria mbretërore jugosllave në emigracion nuk kishte paraqitur pretendime territoriale direkte për Shqipërinë, por nëse Greqia do ta bënte këtë gjë edhe Jugosllavia do të paraqiste kërkesat e veta. Në mënyrë të veçantë, qeveria jugosllave në emigracion ishte shprehur e prerë, për të mos lënë “asnjë inç nga territori i saj për Bullgarinë, Shqipërinë e Greqinë”. Ndhimësinistri i Jashtëm i qeverisë jugosllave në emigracion, Gavril Stojadinoviç në bisedimet e zhvilluara në Kajro me delegacionin bullgar më 6 shtator 1943, kishte deklaruar, “në lidhje me pretendimet e aluduara të Shqipërisë për krahinën e Kosovës e Metohisë, do të duhej një tjetër 28 qershor 1389 për të lënë Kosovën ...”, dhe më tej shtonte: “serbët më parë lënë Beogradin se sa Kosovën”⁴⁷.

Së katërtri, një studim i posaçëm për kufijtë shqiptaro-jugosllavë u hartua nga Departamenti i Kërkimeve në Foreign Office, më 31 korrik 1943, i cili mori formë të plotë në gusht 1944⁴⁸. Duke gjykuar mbi bazën e kriterit etnik pranohej se, kufijtë e vendosur në vitin 1941 ishin në të vërtetë edhe kufij politikë ndërmjet dy vendeve, të cilët ndanin realisht shqiptarët dhe sllavët. Por, po qe se merreshin në konsideratë kriteret gjeografikë dhe ekonomikë, do të duhej që Ulqini dhe lugina e sipërme e Drinit të Zi t’i jepeshin Shqipërisë, ndërsa Jugosllavia duhej të mbante Gucinë, Plavën, Fushën e Kosovës dhe zonën e sipërme të Vardarit. Metohisë do t’i kushtohet një vëmendje e posaçme. Sipas këtij studimi si kufi natyral ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë mund të shërbente kurrizi vijëndarës ndërmjet rrjetit të Drinit dhe rrjeteve të Vardarit dhe

⁴⁷NARA, RG 226, Raport informativ i Harold E. Prude dhe T.A. Thornton, shtator 1943.

⁴⁸TNA, FO 371/37135, “Kufijtë shqiptaro-jugosllavë”, Departamenti i Kërkimit, 26 gusht 1944.

Danubit. Tharja apo drenazhimi i liqenit të Shkodrës kërkonte trajtim të veçantë ndërkombëtar dhe serbët kishin interesa të veçanta për lidhjet ekonomike ndërmjet Shqipërisë së Veriut dhe Adriatikut, prandaj u duhej siguruar një dalje në Adriatik. Nga pikëpamja strategjike vija kufitare e paraluftës gjykohej me të drejtë si kufi krejt në favor të Jugosllavisë. Në studim tërhiqej vëmendja se nëse duheshin ruajtur të ndarë shqiptarët dhe sllavët, duhej që i tërë baseni i Drinit t'i jepej Shqipërisë. Por Jugosllavia kishte interesa strategjike në rajonin verilindor të Shqipërisë dhe donte të vendoste lidhje me portin e Kotorrit. Studimi merrte në konsideratë edhe të drejtën historike, duke justifikuar pretendimet e historianëve serbë për të mbajtur tokat shqiptare nën Jugosllavi, si dhe zotërimin e Shkodrës dhe rrethinave të saj. Në studim pranohet si e drejtë që Shqipëria të merrte disa territore nga Jugosllavia, të cilat përfshinin një popullsi rreth 80.000 banorë, ndërsa 350.000 të tjerë do të vazhdonin të mbeteshin nën Jugosllavinë. Por edhe ato pak ndryshime që rekomandoheshin shiheshin si të vështira për t'u realizuar. Si rezultat, gjykohej si e pamundur që të ndryshonin kufijtë e vendosur në vitin 1926. Si rrugëzgjdhje, për të kënaqur të dyja palët shihej mundësia e vendosjes paraprake të Shqipërisë nën drejtimin e një fuqie të painteresuar, dhe më pas anëtarësimi i saj në një Federatë Ballkanike, anëtare e së cilës do të ishte edhe Jugosllavia.

Një studim i posaçëm për Shqipërinë u hartua në korrik 1944 nga një oficer i lartë i BAF [British Air Force – Forca Ajrore Britanike] britanik, i cili krahas të tjerave merret shkurtimisht edhe me kufijtë shqiptaro-jugosllavë.⁴⁹ Autori, si edhe britanikët e tjerë shfaqet i dyzuar në qëndrimin e tij. Ai merr në konsideratë ndjeshmërinë jugosllave për territoret e banuara nga shqiptarët dhe nga ana tjetër parimin e vetëvendosjes, të artikuluar nga Karta e Atlantikut dhe të drejtën e shqiptarëve për t'u bashkuar me Shqipërinë të bazuar në kriterin etnik. Hodkinson mendon se ndryshimi i kufijve duhet të bëhet vetëm me vullnetin e jugosllavëve; se një pjesë e territorit të Kosovës është e shenjtë për ta, për shkak të Betejës së Kosovës të vitit 1389; se një nga linjat kryesore hekurudhore ndërpritet nga dy degëzimet e linjës Selanik-Shkup-Beograd; se zona e Kosovës ka minerale të pasura me rëndësi për Jugosllavinë. Si përfundim, ai sugjeron që nëse Jugosllavia ka pretendime të bazuara në parimin e nacionalitetit, ajo duhet të pranojë të

⁴⁹ *Po aty*, WO 204/9558, *Shqipëria: 1944*, përgatitur nga H. Hodkinson, BAF, korrik 1944.

drejtat e shqiptarëve për Kosovën. Hodkinson mendon se në rast se Jugosllavisë i jepet territori i Triestes me rreth 500.000 banorë, ajo duhet të pranojë bashkimin me Shqipërinë të pothuajse një numri të barabartë kosovarësh. Serbia sipas tij nuk duhet të ketë pretendime historike për territoret shqiptare në perëndim të linjës hekurudhore, se ajo s' duhet të kërkojë dalje në Adriatik duke qenë në kuadër të Jugosllavisë. Së fundi, ai mendon se zgjidhja më e mirë do të ishte krijimi i një Federate Ballkanike, e cila do të zgjidhte edhe problemin e shqiptarëve në Ballkan.⁵⁰

Në rrethanat kur britanikët hoqën dorë nga zbarkimi në Ballkan (përveç Greqisë), kur lëvizjet e majta të udhëhequra nga komunistët dominonin rezistencën antifashiste në Jugosllavi e në Shqipëri dhe kur Bashkimi Sovjetik po depërtonte me Ushtrinë e Kuqe në Ballkan, diplomacisë britanike i mbeteshin pak ose aspak mundësi për të vendosur për të ardhmen e popujve të këtij rajoni. Në gusht 1944, në FO do të pranonin se problemi i kufijve Shqipëri-Jugosllavi do të ishte atribut kryesisht i forcave që do të vinin në pushtet në Jugosllavi. Nëse në Jugosllavi do të vinin në pushtet (pak a shumë) forcat e para vitit 1941, nuk do të kishte kërkesa për territore shqiptare, por as do të lëshohej ndonjë pjesë nga territoret jugosllave të periudhës së para pushtimit gjerman. Nëse Tito dhe kolegët e tij do të kishin forcën kryesore në qeverinë e ardhshme, Shqipërisë mund t'i bëheshin disa koncesione territoriale. Në mbështetje të kësaj teze përmendet një raport i muajit prill 1944, që vinte nga Misioni Britanik pranë Titos, në të cilin thuhej: "... e ardhmja e Kosovës do të vendoset në një plebishit, ndërsa kufijtë e saj po të jetë e nevojshme do të rregullohen në favor të Shqipërisë". Varianti i fundit parashikonte shpërbërjen e Jugosllavisë dhe daljen më vete të shtetit serb. Në këtë rast Shqipërisë nuk do t'i kthehej asnjë territor, përkundrazi do të ishte Serbia ajo që do të kishte pretendime territoriale ndaj Shqipërisë. Laskey, një nga diplomatët britanikë, më 1 nëntor 1944, shkruante: "Ne nuk duhet ta njohim përfshirjen e Kosovës në Shqipëri. Unë mendoj se duhet të bëjmë gjithçka që të ndalojmë dhënien e këtij rajoni Shqipërisë ... Qeveria jugosllave për sa kohë që do të mbizotërohet nga partizanët, mund të jetë e vullnetshme për ta lënë Shqipërinë që të mbajë Kosovën. Po ..., ata mund të kërkojnë si çmim që Shqipëria të bashkohet me Federatën e Sllavëve të Jugut. Nga pikëpamja shqiptare

⁵⁰ *Po aty.*

unë besoj se ky çmim do të ishte më i keqi për t'u paguar".⁵¹ Pavarësisht nga frazeologjia e përdorur, Partia Komuniste Jugosllave e gjeti më të lehtë rrugëzgjidhjen. Ajo nuk pranoi të lëshonte asgjë nga territoret e parapushtimit, por u përpoq të krijonte një federatë, brenda së cilës do të inkuadrohej edhe Shqipëria.

Studime amerikane:

Studime për kufijtë shqiptaro-jugosllavë u ndërmorën edhe nga Departamenti i Shtetit. Studimi i parë i njohur prej nesh u hartua më 2 shtator 1943.⁵² Autorët vënë në dukje kërkesat e ndryshme kundërshtuese të shqiptarëve dhe jugosllavëve për problemin e kufijve. Të parët dëshironin një kufi të mbështetur në pikëpamje etnike, ndërsa të dytët rikthimin e Jugosllavisë në kufijtë e vitit 1941 dhe siguri maksimale për të garantuar shtetin jugosllav nga ndonjë sulm i mundshëm përmes tokës shqiptare. Në studim parashikohen disa opsione. Alternativa e parë parashikonte rivendosjen e kufijve të vitit 1941 ndërmjet të dy vendeve. Një zgjidhje e tillë, sipas studimit, do të shoqërohej me problemin e irredentizmit të shqiptarëve, të cilët do të vazhdonin si më parë të rezistonin dhe të mos i bindeshin shtetit jugosllav. Alternativa e dytë parashikonte disa ndryshime të vogla të kufirit në favor të Shqipërisë. Kësaj të fundit do t'i kalonin 4 distrikte administrative jugosllave, si Gjakova, Podgorica, Podrimja, Gora dhe qyteti i Dibrës, me një popullsi të përzier myslimane e ortodokse që arrinte në 165.000 banorë. Në këtë rast, Jugosllavia do të humbte disa avantazhe strategjike, ndërsa humbjet ekonomike të saj do të ishin të papërfillshme. Alternativa e tretë parashikonte që Shqipërisë t'i ktheheshin të gjitha distriktet jugosllave me predominim shqiptar, të cilat përfshinin një popullsi afro 660.000, nga e cila 444.000 banorë myslimanë dhe 196.000 ortodoksë. Shqipëria, sipas këtij varianti do të mbante të gjithë territorin që i ishte bashkuar asaj në vitin 1941, duke përfshirë edhe Strugën me predominim sllav. Minierat e kromit do t'i mbeteshin po kështu Shqipërisë. Përmeshja e kësaj alternative do të shoqërohej me kundërshtimin e fortë të Jugosllavisë. Sidoqoftë, për të zbutur situatën shihej si mundësi mbajtja e

⁵¹ Paskal Milo, "Fuqitë e Mëdha dhe çështja e Kosovës gjatë dhe në përfundim të LDB", në *Konferenca e Bujanit*, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë: 1999, f.51.

⁵² NARA, 875.00/10-44, Sekret M-46, C.B. Black-J.C. Campbell: "Jugosllavia: Shqipëria, Probleme territoriale: kufiri shqiptaro-jugosllav", 2 shtator 1943.

plebishiteve në zonat me dominim të popullsisë sllave. Alternativa e fundit dhe më e keqja për shqiptarët, parashtronte idenë e rishikimit të kufijve të Shqipërisë të vitit 1913, duke i shkëputur edhe Shkodrën me territoret përreth dhe duke ia bashkëngjitur Jugosllavisë.

Studimi i dytë, më i detajuar për kufijtë shqiptaro-jugosllavë u përgatit më 12 nëntor 1943.⁵³ Studimi ka disa të përbashkëta me studimin e shtatorit, por edhe disa ndryshime. Campbell nënvizon dëshirën e shqiptarëve, për kthimin e territoreve shqiptare duke respektuar parimin etnik. Në studim vihet në dukje se “Britania e Madhe ka treguar disa shenja të gatishmërisë për të mbështetur kërkesat greke e jugosllave për kufijtë, duke kërkuar rishikimin në favor të tyre”.⁵⁴ Autori parasheh si zgjidhje të parë rivendosjen e kufijve të paraluftës ndërmjet të dy vendeve. Por, shton ai më tej, nëse Jugosllavia shpërbëhet, shteti serb për arsye sigurie do të kërkonte të shpërblehej me territore shqiptare. Kjo do të shoqërohej me rritjen e përqindjes së minoritetit shqiptar brenda Serbisë e cila gjykohej se nuk do të kishte mundësi të absorbonte e administronte një numër kaq të madh shqiptarësh. Alternativa e dytë parashikonte zgjerimin e shtetit shqiptar me 6 distrikte të shtetit jugosllav të paraluftës (Peja, Gjakova, Podrimja, Podgora, Stara Pllanina dhe Gora), ku popullsia shqiptare ishte shumicë dhe me 5 të tjera (Tivari, Podgorica, Andrijevicë, Goliçnik, Dibra) ku ata nuk ishin shumicë. Sipas kësaj alternative Shqipërisë do t’i bashkoheshin 254.000 banorë, nga të cilët 80% shqiptarë dhe 19% sllavë. Ky projekt, gjykonte hartuesi do të vendoste kufij etnik logjik ndërmjet Shqipërisë dhe shtetit maqedon që mund të krijohet pas luftës. Me këtë ndryshim Jugosllavia do të humbiste disa avantazhe strategjike, por të papërfillshme përse i përkiste rëndësisë ekonomike. Alternativa e tretë parashikonte ruajtjen e kufijve të vendosura nga fuqitë e Boshtit në vitin 1941. Nëse zbatohet ky version Shqipërisë do të shtoheshin 678.000 banorë (regjistrimi i vitit 1931), duke përfshirë 460.000 shqiptarë (68%) dhe 209.000 sllavë (31%). Territori shqiptar do të zgjerohet në luginën e Vardarit, ndërsa kufiri do të ndërpriste vijën hekurudhore Kragujevac-Mitrovicë-Shkup, me rëndësi të madhe për komunikimin me Jugosllavinë Jugore. Kjo zgjidhje përfaqësonte maksimumin e përmbushjes së aspiratave shqiptare, por që do të kundërshtohet fort nga Jugosllavia. Sidoqoftë, për të zbutur

⁵³ *Po aty*, N 46 a, JCC, Campbell, “Problemet territoriale: kufiri jugosllavo-shqiptar”, 12 nëntor 1943.

⁵⁴ *Po aty*.

kundërshtimin e jugosllavëve, në studim sugjerohej që në zonat me shumicë sllave të zhvilloheshin plebishite për të ardhmen e tyre dhe pastaj mund të procedohej më tej me shkëmbimin e popullsisë respektive. Varianti i fundit mbështeste idenë e rishikimit të kufijve të paraluftës në favor të Jugosllavisë. Kjo e fundit në këtë rast do të përvetësonte territore shqiptare në veri, duke përfshirë zonën e populluar dendur të qytetit të Shkodrës. Kjo ndarje do t'i shkëpuste Shqipërisë rreth 100.000 banorë, duke e shtuar shumë minoritetin e shqiptarëve në Jugosllavi. Sipas autorit, Jugosllavia do të fitonte avantazhe të padiskutueshme strategjike ndaj Shqipërisë, por do të shtonte numrin e një popullsie armiqësore e irredentiste brenda territorit të saj. Kjo zgjidhje do të kundërshtohej fort nga shqiptarët dhe do të ishte dhunim i Kartës së Atlantikut.

Në rrethanat kur rikthimi i territoreve shqiptare, Shqipërisë, konsiderohej një alternativë e pamundur, aleatët anglo-amerikanë i trembeshin hakmarrjes së trupave jugosllave pas kthimit të tyre në Kosovë. Në një dokument të FO mbi situatën shqiptare, të datës 25 gusht 1944, parashikohej që në Kosovë të ndërhynin 5000 forca amerikane, detyrë kryesore e të cilëve do të ishte shmangia e hakmarrjes së tmerrshme dhe mbrojtja e kosovarëve irredentistë nga trupat jugosllavë⁵⁵. Por ky shqetësim i drejtë nuk u materializua, dhe më vonë ndodhën ato që priteshin. Në DSH dhe në FO duket se kishte një besim të pajustificuar tek Titoja. Masakrat jugosllave mbi shqiptarët nën Jugosllavi duket se nuk i shqetësuan britanikët, të cilët kishin dijeni për to.

Kufijtë jugorë të Shqipërisë

Për kufijtë shqiptaro-grek janë përgatitur disa studime të posaçme nga institucione të specializuara të Departamentit të Shtetit⁵⁶ apo Foreign Office. Studimi i parë i britanikëve (i njohur prej nesh) u hartua më 18 shkurt 1941 nga ish ministri i Britanisë së Madhe në Shqipëri, Andrew Rayan⁵⁷. Ai fokusohej kryesisht tek e ardhmja e Shqipërisë pas LDB, por në mënyrë të pjesshme trajtoi edhe çështjen e kufijve të saj. Autori në

⁵⁵ P. Milo, "Fuqitë e Mëdha dhe çështja e Kosovës ...", f.50.

⁵⁶ Departamente të specializuara të Departamentit të Shtetit kanë përgatitur dy studime të posaçme për kufijtë shqiptaro-grek, të cilët përmenden nga sekretari Amerikan i Shtetit, Cordell Hull në tetor 1944 por, për fat të keq unë nuk i kam ndeshur në kërkimet e mia në NARA.

⁵⁷ TNA, FO 371/29711, f. 77-78.

përgjithësi i përmbahet idesë se shteti shqiptar i pasluftës duhet të ruaj kufijtë e paraluftës. Ai nuk i justifikon pretendimet territoriale të qeverisë greke në emigracion ndaj Shqipërisë, për arsye se, nga pikëpamja ekonomike rajonet e pretenduara prej saj kishin rëndësi jetike për ekzistencën e shtetit të pavarur shqiptar. Por, duke pasur në konsideratë kërkesat e forta të Greqisë për Shqipërinë e Jugut, Rayan e mendon të ardhmen e Shqipërisë, të përfshirë në një Pakt Ballkanik. Sidoqoftë, duke qenë një njohës i mirë i shqiptarëve dhe kërkesave të tyre për pavarësi ai arrinte në konkluzionin se “Shqipëria nuk zotërohet me forcë, por ajo duhet lënë e lirë që të pranojë apo refuzojë kontrollin [e huaj], për të përfutur apo lënë mënjane ndihmën e tyre”.⁵⁸

Studimi i dytë i titulluar: “*E ardhmja e Shqipërisë*” u hartua më 6 janar 1942 nga R.G.D. Laffan.⁵⁹ Autori e sheh shtetin e ardhshëm shqiptar të përfshirë në një Konfederatë apo Federatë të vendeve ballkanike, e cila do t’i sfumonte kërkesat territoriale të fqinjëve ndaj territoreve shqiptare. Por Laffan shfaq rezerva për përfshirjen e Shqipërisë në një Federatë Ballkanike. Në këtë rast, ai shfaq dyshime për mbijetesën e Shqipërisë e cila, sipas tij, do të dominohej nga fqinjët grekë e jugosllavë. Shqipëria do të ishte një lloj sanduichi ndërmjet Greqisë dhe Jugosllavisë. Për të shmangur këtë fenomen ai rekomandon krijimin e një Federate të gjerë të vendeve të Evropës Lindore. Ruajtjen e një shteti shqiptar të pavarur dhe me kufij të stabilizuar në veri e në jug, autori e kushtëzon me krijimin e një Sistemi të Sigurisë Evropiane, e cili do të përcaktonte disa kushte për mbrojtjen e shteteve të dobët, ndër të cilët përfshihej edhe Shqipëria. Për ruajtjen e kufijve të Shqipërisë, autori sugjeron vendosjen e trupave ndërkombëtare në disa zona delikate, si në Vlorë, Korçë, Shëngjin e Shkodër, të cilat do t’i detyronin fqinjët të respektonin kufijtë e Shqipërisë. Laffan e përfundon studimin me konkluzionin se “nëse fuqitë anglisht-folëse (në bashkëpunim me disa të tjera) janë të përgatitura të mbajnë nën kontroll Evropën, kjo do të duket tek fati i ardhshëm i Shqipërisë, i cili në fund të fundit do të jetë ndarja nga fqinjët e saj ose përfshirja në një Federatë. Në rastin e dytë, do të sugjeroja që një Shqipëri e vetëqeverisur ..., do të ishte më e sigurt në një Federatë të gjerë të Evropës Lindore, jo e dominuar nga dy fqinjët e Shqipërisë [Greqia e Jugosllavia], se sa në një Federatë Ballkanike”.⁶⁰

⁵⁸ *Po aty*, f. 78.

⁵⁹ *Po aty*, FO 371/33107, R.G.D. Laffan, “E ardhmja e Shqipërisë”, 6 janar 1942.

⁶⁰ *Po aty*, f. 9.

Një studim i posaçëm për ‘kufijtë greko-shqiptarë’ u përgatit nga Macartney më 28 janar 1943.⁶¹ Studimi sqaron konceptin “Epir i Veriut” dhe Shqipëri e Jugut, të cilat janë e njëjta gjë. Macartney nuk i gjen me vend gjykimet se për të përcaktuar karakterin etnik të popullsisë së rajonit të pretenduar nga Greqia duhet të mbështetesh në pikëpamjet racore, fetare apo gjuhësore. Epiri përpara vitit 1912, shkruan Macartney, kishte më shumë myslimanë se të krishterë, dhe banohej nga shqiptarë dhe grekë. Feja sipas tij nuk e përcakton dot nacionalitetin e banorëve të këtij rajoni. Gjuha gjithashtu nuk mund të përcaktojë nacionalitetin e banorëve të kësaj treve, sepse greqishtja ka qenë gjuha e kishës dhe e tregtisë. Ai gjykonte se ndërjegjija greke tek shqiptarët kishte pësuar tkurrje pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar. Sipas Macartney-t edhe kriteri ekonomik nuk i justifikonte pretendimet greke. Duke iu referuar kriterit strategjik si faktor që mund të justifikonte pretendimet greke ndaj Shqipërisë, ai shfaq mendimin se ky faktor dikur mund të ketë pasur ndonjë vlerë, por tanimë ai e ka humbur atë. Pretendimet greke për një kufi më të mirë me Shqipërinë, i cili do të kalonte në male, sipas Macartney-t janë të kaluara në kohë. Avancimet teknologjike dhe sidomos përdorimi i aviacionit nuk e justifikon më këtë pretendim të Greqisë. Duke mos e anashkaluar fare kriterin strategjik, ai mendon se mbi bazën e tij mund të justifikohet ndonjë ndryshim territorial në favor të Greqisë, në zonën përballë Korfuzit. Por, edhe ky ndryshim do ta humbte vlerën nëse Shqipëria dhe Greqia do të ishin anëtarë të Bashkimit Ballkanik. Macartney konkludonte se problemi kombëtar nuk zgjidhej me ndryshim kufijsh. Nacionalizmi grek në Shqipëri ishte në rënie. Ky fenomen ishte i dukshëm sidomos tek brezi i ri i popullsisë shqiptare. Autori u sugjeronte grekëve të mos i drejtonin sytë tek “Epiri i Veriut”, por tek Qipro dhe ishujt Dodekanezë. Vërejtjet e fundit të Macartney-t ndeshën në kundërshtimin e drejtuesit të Departamentit të Evropës Jugore, D.F. Haward në Foreign Office, i cili prirej drejt një zgjidhjeje që favorizonte Greqinë.⁶²

Një tjetër studim me titull: “*Shqipëria si problem ndërkombëtar*” u përgatit në shkurt 1943 nga Laffan dhe Macartney.⁶³ Në studim pranohet

⁶¹ TNA, FO 371/37135, Macartney (Foreign Research and Press Service, Balliol College, Oxford) “Kufijtë greko-shqiptarë”, 28 janar 1943.

⁶² *Po aty*, f. 13.

⁶³ *Po aty*, FO 371/371135, Macartney, Laffan “Shqipëria si problem ndërkombëtar”, 23 shkurt 1943, f. 61-72.

se kërkesat greke për territore shqiptare janë më të forta se ato jugosllave. Pranohet gjithashtu se brenda territoreve greke gjenden shqiptarë çamë. Në studim arrihet në konkluzionin se dhënia e ¼ të territoreve shqiptare Greqisë, do ta bënte ekstremisht të vështirë ekzistencën e shtetit shqiptar. Bashkimi i Korçës me Greqinë do t'i hiqte Shqipërisë qytetin e tretë më të madh të vendit, dhe njëkohësisht një qendër të madhe me rëndësi bujqësore e minerare. Po kështu zona e Delvinës konsiderohej një rajon i pasur bujqësor, e cila banohej nga një popullsi me ndjesi të veçantë amerikane dhe më progresive se ajo e Shqipërisë së Mesme dhe e Veriut. Sipas të dy studiuesve, rajoni i Delvinës në pikëpamje ekonomike kishte rëndësi vitale për Shqipërinë, por jo për Greqinë. Studimi nuk e justifikon ekzistencën e një shteti shqiptar plotësisht të pavarur, sepse mund të bëhej urë për ndërhyrjet e fuqive të tjera kundër Greqisë dhe Jugosllavisë. I vetmi kriter që deri diku do të justifikonte pretendimet greke sipas autorëve të këtij studimi, ishte kriteri strategjik. Sidoqoftë, ekzistenca e një shteti shqiptar nën garancinë ndërkombëtare për një periudhë të caktuar kohe mbetej zgjidhja më e mirë, që do të neutralizonte edhe problemin e kufijve.⁶⁴

Studimi më i plotë për *kufijtë jugosllavo-shqiptarë dhe greko-shqiptarë* që ne njohim, u përgatit nga Departamenti i Kërkimeve pranë Foreign Office, më 26 gusht 1944.⁶⁵ Ai shoqërohet me disa harta për zonat e diskutuara e pretenduara nga qeveria greke në emigracion. Në një letër shoqëruese të zyrtarit të lartë të FO, J. D. Mabbott do të tërhiqej vëmendja se me që Shqipëria do të ishte një vend i pavarur 'ne nuk duhet të merremi vetëm me pretendimet jugosllave kundër Shqipërisë, por edhe me pretendimet e mundshme të Shqipërisë kundër jugosllavëve'. Një vrejtitje e tillë nuk figuronte për territoret shqiptare të Çamërisë, të cilat i ishin nënshtruar procesit të egër të spastrimit etnik nga territoret e tyre stërgjyshore. Studimi arrinte në disa përfundime të rëndësishme. *Së pari*, pretendimet greke për territoret shqiptare vlerësoheshin si të fuqishme, por të dyshimta në planin historik, etnik e gjuhësor; të pabaza në planin ekonomik dhe më pak të justifikuar se pretendimet greke për ishujt Dodekanez dhe Qipron në planin strategjik. *Së dyti*, nënvizohej kronologjia e kërkesave të qeverisë greke në emigracion veçanërisht në kohën e kryeministrit Tsouderos, të Papandreut, por edhe të EAM-it, i

⁶⁴ *Po aty*.

⁶⁵ *Po aty*, FO 371/43567, Departamenti i Kërkimeve në FO, "Kufijtë shqiptaro-grek", 26 gusht 1944.

cili ishte detyruar të shtonte në programin e vet një pikë për korrigjimin e kufijve. *Së treti*, argumentohej vlera jetësore për Shqipërinë e territoreve të pretenduara nga grekët, e cila banohej nga një popullsi rreth 230.000 mijë vetë, duke vënë theksin tek qyteti i Korçës si qendër e rëndësishme e kulturës dhe nacionalizmit shqiptar, por edhe tek vlerat ekonomike, shoqërore e kulturore të zonave të tjera të Jugut me sentiment proamerikan. Në studime pranohej se në zonat e pretenduara ekziston sentiment i helen, por ai kishte karakter kulturor dhe jo politik dhe se shqiptarët nuk e duan bashkimin me Greqinë. Sidoqoftë, humbja e Delvinës dhe Butrintit gjykohej si shumë serioze për Shqipërinë, por jo fatale për pavarësinë e saj. Studimi përfundonte me konkluzionin e drejtë se cenimi i territoreve shqiptare, sado të vogla qofshin ato, do ta bënte të cenueshme dhe mbase të paqëndrueshme pavarësinë e Shqipërisë. Si rrugëzgjdhje shihej përfshirja e Shqipërisë në Bashkimin Ballkanik.

Më 6 maj 1944, Komiteti për Rajonin Ballkaniko-Danubian pranë Departamentit të Shtetit hartoi një studim të posaçëm për statusin ndërkombëtar të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, në të cilin u cek edhe problemi i kufijve të ardhshëm të Shqipërisë me Jugosllavinë e Greqinë.⁶⁶ Krahas alternativave të tjera u përmend edhe një variant që parashikonte ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Greqisë e Jugosllavisë. Hartuesit vinin në dukje se ky variant ishte pëlqyer e nënkuptuar në disa raste nga përfaqësuesit e dy shteteve fqinjë. Ai “bazohej në argumentin” se një Shqipëri e pavarur do të ishte e dobët dhe e paaftë të parandalonte ndonjë sulm italian kundër tyre, duke shfrytëzuar territorin shqiptar. Por, për opinionin e DSH, një alternativë e tillë ishte ekstreme dhe e papërshtatshme për t’u zbatuar. Ndër arsyet e vëna në dukje përmendej kundërshtimi i saj i fortë që do t’i bënin shqiptarët; dhunimi i Kartës së Atlantikut dhe i deklaratave të SHBA e Britanisë së Madhe të dhjetorit 1942 për ringritjen e një shteti të pavarur shqiptar pas lufte. Por një zgjidhje e tillë nuk do të ishte e mirë as për vetë shtetet fqinjë, sepse ato nuk kishin kapacitetet e duhura për të absorbuar e menaxhuar një numër të madh shqiptarësh brenda shteteve të tyre. Si rrjedhojë, zgjerimet e fqinjëve në kurriz të Shqipërisë do të ktheheshin në disavantazh për vetë Greqinë e Jugosllavinë. Duke pasur në konsideratë dobësinë e shtetit të ardhshëm shqiptar dhe duke dashur të mënjanojnë rrezikun e përdorimit

⁶⁶ NARA, 875.00/10-2144, Sekret, H. 97, “Statusi Ndërkombëtar i Shqipërisë”, përgatitur nga Komiteti për Rajonin Ballkaniko-Danubian, 6 maj 1944.

të territorit shqiptar si trampolinë kundër shteteve fqinjë, në studim hidhej ideja që shteti shqiptar i pasluftës të kishte një status neutral.⁶⁷

Diplomacia britanike në mbarim të luftës u gjend në dilemë për Shqipërinë dhe kufijtë e saj. Nëse do t'i jepeshin territore shqiptare Greqisë, vështirë se shteti shqiptar do të mbijetonte; nëse nuk i jepeshin, në Ballkan, sipas saj, do të kishte një vatër tensioni. Si mjete më i përshtatshëm ishte krijimi i një federate ballkanike, por në Jugosllavi po fitonin forcat e Titos, i cili po orientohej drejt Bashkimit Sovjetik. Ky i fundit nga ana tjetër po avanconte në Ballkan duke përdorur forcat e Ushtrisë së Kuqe. Britania e Madhe, në mbarim të luftës e kishte humbur forcën e mëparshme dhe nuk ishte më një faktor përcaktues. Një tjetër faktor me peshë ishte Lëvizja Nacionalçlirimtare [LNÇL], e cila i kundërshtoi me forcë pretendimet greke për territore shqiptare. SHBA dhe Britania e Madhe në mbarim të luftës u përballën me kërkesat e qeverisë greke për Shqipërinë e Jugut, por edhe me pretendimet e saj për ta konsideruar Shqipërinë një vend armik. Qeveria greke u tregua e gatshme të fuste trupat e veta ushtarake në zonat e pretenduara. Qeveria amerikane, në tetor 1944, e bëri të qartë politikën e saj për këtë çështje, duke deklaruar se kufijtë e paraluftës do të vazhdonin të ishin kufij legalë, dhe se forcat e armatosura të Greqisë e Shqipërisë nuk duhet të kalonin kufijtë. Qeveria amerikane premonte se do t'i dëgjonte pretendimet e qeverisë greke Konferencën e Paqes.⁶⁸ Ndërkohë, qeverisë amerikane iu bë e njohur deklarata e Enver Hoxhës në fjalën e mbajtur gjatë çlirimit të Tiranës, se kufijtë shqiptaro-grekë duhet të mbeteshin si ishin.⁶⁹ Ndërkohë Radio Londra transmetonte pretendimet greke për kufijtë shqiptarë, ndërsa Hoxha besonte se komandot britanike që morën pjesë në çlirimin e Sarandës kishin si qëllim që ta shmangnin qeverinë shqiptare nga kontrolli mbi kufirin e Jugut. Në ato rrethana Hoxha vazhdoi të këmbëngulte se ai do të luftonte nëse trupat grekë hynin në territorin shqiptar.⁷⁰

Deklarata e Konferencës së Jaltës në shkurt 1945 vulosi përfundimisht restaurimin e Jugosllavisë në kufijtë e paraluftës, duke i lënë shqiptarët nën Jugosllavi. Aspiratat e shqiptarëve për bashkim morën

⁶⁷ *Po aty*.

⁶⁸ NARA, 875.01/11-644, Telegram i Edward Stettinius [zëvendëssekretar i Shtetit] drejtuar Caserta-s, më 23 tetor 1944.

⁶⁹ *Po aty*, 875.01/12-544, Kirk për sekretarin e Shtetit, 5 dhjetor 1944.

⁷⁰ *Po aty*, 875.01/12-644, Kirk për sekretarin e Shtetit, më 6 dhjetor 1944.

sërish një goditje të madhe, ndërsa shteti i pafuqishëm shqiptar ishte i rrezikuar nga pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut. Shqipëria shkante në Konferencën e Paqes së Parisit, duke mos pasur një qeveri të njohur nga dy ish-aleatët anglo-amerikanë, pa qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe pa statusin juridik të një vendi aleat.

S u m m a r y

ALBANIAN BORDERS IN THE PROJECTS OF GREAT ALLIES DURING SECOND WORLD WAR

This paper constitutes an effort to address the problem of Albania's borders after the Second World War, in the perspective of the three great allies, namely the USA; UK and the USSR. Specialized institutions of these countries prepared several studies concerning Albania's borders and its international status during the WWII. Their purpose was to aid their respective governments in the process of decision making and policy drafting for specific issues regarding Albania after the end of the war. However, the studies prepared by these institutions cannot be considered official policies since this was an exclusive attribute of their governments.

In the article one can easily note the differences between British and American studies regarding the northern and southern borders of Albania, stemming from their different policies. Without doubt, we can state that studies of the State Department are more realistic than the British ones, but not nearly enough to encompass Albanians aspirations in the Balkans. The second part of the article includes summaries of a few British and American studies on the northern and southern borders of Albania, which contain all possible hypothetical variants, without taking into account if they were in favor or in disfavor to Albania.

For writing this paper, I have used documents from the British, American and to a lesser extent from Russian archives. Unfortunately the Russian stance on Albania's borders is not complete due lack of sources, while the stances of the other two allies are much more comprehensive.

